



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 62, datë 04.06.2020

**“PËR
TRAJTIMIN ME BONUS STREHIMI TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË QË NUK
MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 77, pika 10, të Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr. 814, datë 03.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.06.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit nr. 243, datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” të ndryshuar, Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2008 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për përmbajtjen e bonusit të strehimit”, Vendimit nr. 11, datë 05.02.2020, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e komisionit të strehimit”, Vendimit nr. 15, datë 02.05.2012 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të bonusit të strehimit për tre zona të qytetit të Tiranës për familjet në nevojë për strehim”, pikën 1, shkronja “c”, të Vendimit nr. 43, datë 20.11.2012 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për bonusin e strehimit, sistemin të pikëzimit për subvencionimin e familjeve që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti dhe sistemin e pikëzimit për programin e banesave sociale me qira”, të ndryshuar, Vendimit nr. 91, datë 26.07.2018, të Këshillit Bashkiak “Për zbatimin e udhëzuesit operacional mbi përfitimin e bonusit të strehimit në Bashkinë Tiranë”, Urdhëresës nr.3198 datë 30.11.2012, e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës “Mbi procedurat që duhet të ndiqen dhe dokumentacioni i nevojshëm për të përfituar nga programi i bonusit të strehimit”, si dhe në vendimin e marrë nga Komisioni i Strehimit, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

I. Të miratojë trajtimin me bonus strehimi familjet si më poshtë:

Emër Atësi Mbiemër

Shuma që përfiton

1. Xhevair Ramiz Kovaçi	15000
2. Anila Kadri Dani	11790
3. Anila Jakup Kurtaj	11000
4. Pal Ndue Ndoj	11790
5. Enkeleda Ramazan Bulku	8074
6. Marjeta Myslym Shalsa	6960
7. Floresha Vidi Rapaj	11790
8. Elora Ibrahim Musaj	8044
9. Rozeta Ferik Herri	8513
10. Elida Kristo Naqellari	6960
11. Sonila Pëllumb Shehu	6960
12. Ruzhdi Mustafa Cullhai	6960
13. Matilda Artan Mina	16870
14. Blerina Bujar Pajënga	6960
15. Mirela Zenun Beqiri	6960
16. Lutifie Nazmi Këmbaci	6960
17. Lulëzim Musa Lici	6960
18. Alban Andrea Disho	11790
19. Ivzi Mustafa Ismaili	6960
20. Ina Jemin Balla	11790
21. Ilir Lutfi Koblara	10471
22. Artur Xhemal Kiro	9230
23. Mikail Perikli Pani	9717
24. Adivije Iljaz Hasimi	11790
25. Mario Hamit Martini	5316
26. Maria Jovan Stavro	6960
27. Filip Pëllumb Kondi	6960
28. Shahin Mehet Hurshiti	13039

29. Marsela Ramazan Tahiri	11790
30. Banush Sadush Çerma	6960
31. Bledi Hysni Avdiaj	6960
32. Migena Naun Tolli	6960
33. Zamir Hasan Sala	6960
34. Mehmet Rexhep Gashi	6960
35. Agron Zeqo Fisheku	11790
36. Floresha Asllan Bushaj	11790
37. Julian Hismet Drazhi	6960
38. Refian Bahri Kodra	6960

Total = 346664 (treqind e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.

II. Efektet financiare që rrjedhin nga pika “I”, në shumën prej 346664 (treqind e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj, do të përballohen nga fondi i përcaktuar nga zëri i bonusit të strehimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë.

III. Efektet financiare kanë një kohëzgjatje 1 (një) vjeçare, nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.

IV. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R I

TONI GOGU